

DEKLARATE

I nenshkruari:

Karen Elizabeth D'Leon-Groot, me poshte referuar si: "notere e se drejtes civile", si zevendesuese e Hendrikus Johannes Portengen, noter i se drejtes civile me zyre ne Rotterdam, Hollande,

me ane te kesaj deklarate verteton se:

firmat e paraqitura ne dokumentin e bashkengjitur jane firmat e verteta dhe origjinale te:

- Lamberdina Regina Maria Kraan, e lindur ne Gouda, Hollande, me 23 Shtator 1963, mbajtese e pasaportes hollandeze me numer NN803LP87 leshuar nga Kryetari i Bashkise se Utrecht, Hollande, e vlefshme deri me 23 Shkurt 2016; dhe
- Erik Antonius Jacobus de Rijk, i lindur ne Hage, Hollande, me 5 Mars 1960, mbajtes i pasaportes hollandeze me numer BWBHFBBPP9, leshuar nga Kryetari i Bashkise se Hages, Hollande, e vlefshme deri ne 3 Janar 2017.

Bazuar ne regjistrimin e bere ne Regjistrin Tregtar te Dhomes hollandeze te Tregtise me numer 27166573, Z. E.A.J. de Rijk eshte anetar i bordit drejtues dhe Znj. L.R.M. Kraan eshte mbajtese e prokures me titullin e Sekretare e Kompanise te **Vodafone Europe B.V.**, nje shoqeri private hollandeze me pergjegjesi te kufizuar, me zyre qendrore ne Rotterdam, Hollande, dhe adrese zyre (2909 LC) Capelle aan den IJssel, Hollande, Rivium Quadrant 173, dhe si te tille, sipas regjistrimit te permendur me lart, dhe statutit te Vodafone Europe B.V., ne fuqi nga data e shenuar ne regjistrimin si me siper, jane plotesisht te autorizuar per te perfaqesuar Vodafone Europe B.V. se bashku dhe te nenshkruajne dokumentin e bashkengjitur ne emer te Vodafone Europe B.V.

Bazuar ne regjistrimin e bere ne Regjistrin Tregtar te Dhomes hollandeze te Tregtise me numer 24320466, Z. E.A.J. de Rijk eshte anetar i bordit drejtues dhe Znj. L.R.M. Kraan eshte mbajtese e prokures me titullin e Sekretare e Kompanise te **Vodafone Panafon International Holdings B.V.**, nje shoqeri private hollandeze me pergjegjesi te kufizuar, me zyre qendrore ne Rotterdam, Hollande, dhe adrese zyre (2909 LC) Capelle aan den IJssel, Hollande, Rivium Quadrant 173, dhe si te tille, sipas regjistrimit te permendur me lart dhe statutit te Vodafone Panafon International Holdings B.V., ne fuqi nga data e shenuar ne regjistrimin si me siper, jane plotesisht te autorizuar per te perfaqesuar Vodafone Panafon International Holdings B.V. se bashku dhe te nenshkruajne dokumentin e bashkengjitur ne emer te Vodafone Panafon International Holdings B.V.

Vertetesia e ketij dokumenti kufizohet plotesisht nga vertetimi i identitetit dhe firmave te personave te permendur ne kete dokument si dhe ne te drejten e tyre per te perfaqesuar personat ligjore te permendur ne kete dokument. I nenshkruari, noteri civil, nuk gjykon - pervec te tjerash - mbi permbajtjen dhe pasojat e mundshme ligjore te dokumentit bashkelidhur ose ndonje tjeter aspekt te tij.

Duhet theksuar se sipas ligjit hollandez per korporatat, ekzistojne perjashtime te vecanta te parimit te pergjithshem qe nje person, i cili merret me nje shoqeri, duke vepruar ne mirebesim, mund te marre per baze informacionin e nje shoqerie te tille qe eshte e regjistruar ne regjistrin tregtar, informacion i cili eshte baza e deklaratave te mesiperme. Per shembull, kufizimet mund te zbatohen ne lidhje me aftesine e nje shoqerie per te hyre ne nje transaksion dhe aftesise se anetareve te bordit te saj drejtues per te perfaqesuar kete shoqeri nese transaksioni ne fjale eshte me ves (*doelovershrijding*) ose asistence financiare (*financiële steunverlening*).

Kjo certifikate mund te merret per baze vetem me kushtin e shprehur qe te gjitha ceshtjet e interpretimit ose te pergjegjesise qe rrjedhin prej saj do te rregullohen nga ligji hollandez dhe do te sillen ekskluzivisht perpara nje Gjykate hollandeze dhe eshte objekt i Kushteve te Pergjithshme te Loyens & Loeff N.V. (juriste, keshilltare taksash dhe notere te se drejtes civile)¹, te cilat perfshijne nje klauzole te kufizimit te pergjegjesise.

Nenshkruar ne Rotterdam, Hollande, me 22 Korrik 2014.

[Nenshkrimi]

K.E. D'Leon-Groot

[Vula]

APOSTILLE

¹ Keto kushte u depozituan ne Regjistrin e Gjykates se Distriktit te Roterdamit me 1 Korrik 2009 me numer 43/2009 dhe mund te gjenden ne faqen e internetit <http://www.loyensloeff.com>

1. **(Konventa e Hages e 5 Tetorit 1961)**
Shteti: HOLLANDE
Ky dokument publik
2. eshte nenshkruar nga K.E. D'Leon-Groot
3. ne cilesine e saj si zevendesuese e
4. i cili mban vulen e
Z. H.J. Portengen ne Rotterdam
u vertetua
5. ne Rotterdam 6. me 22 Korrik 2014
7. nga nepunesi i Gjykates se Rrethit

(Griffier van de Rechtbank)

8. Nr. HA RP 14/4610
9. Vula 10.Firma
D.A.C. Saija-Kruit



VODAFONE ALBANIA SH.A.
SHOQERI AKSIONARE ME OFERTE PRIVATE
Autostrada Tirane-Durres
Rr. Pavaresia, Nr. 61, Kashar
Tirane, Shqiperi

**PROCESVERBAL DHE VENDIM
I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE AKSIONEREVE**

Mbajtur me 22 Korrik 2014
Ne oren 11:00

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te Vodafone Albania Sh.A. (me poshte referuar si "Shoqeria") u mblodh me 22 Korrik 2014 ne Rivium Quadrant 173, kati 15-te, 2909 LC Capelle aan den IJssel, Hollande.

Te pranishem jane anetaret si me poshte:

1. Erik de Rijk dhe Dennis Kraan, perfaqesues te Vodafone Europe B.V., dhe
2. Erik de Rijk dhe Dennis Kraan, perfaqesues te Vodafone Panafon International Holdings B.V., dhe

Rendi i dites i mbledhjes eshte miratimi i llogarive financiare te Shoqerise per periudhen 1 Janar 2013 deri me 31 Dhjetor 2013.

Administratori i Shoqerise Z. Dietlof Ziegfried Mare paraqiti perpara anetareve te pranishem raportin mbi aktivitetin e Shoqerise gjate periudhes 1 Janar 2013 – 31 Dhjetor 2013 dhe paraqiti perpara Asamblese se Pergjithshme llogarite e Shoqerise per kete periudhe, te cilat jane miratuar nga Keshilli i Administrimit te Shoqerise ne mbledhjen e dates 30 Qershor 2014 dhe jane konfirmuar nga "Raporti i Auditorit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare nga dhe per vitin qe perfundoi ne 31 Dhjetor 2013", te pergatitur nga eksperti kontabel Deloitte Albania sh.p.k..

Asambleja e Pergjithshme veren se Raporti i Auditoreve te Pavarur konfirmon saktesine e llogarive te Shoqerise paraqitur nga Administratori.

Gjithashtu, me propozim te Administratorit te Shoqerise, Asambleja e Pergjithshme diskutoi mbi caktimin e PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. si audit/eksperte kontabel te autorizuar te ri te Shoqerise duke filluar qe nga data 21 Maj 2014.

Pas diskutimeve te zhvilluara, Asambleja e Pergjithshme VENDOSI unanimisht te miratoje llogarite financiare te Shoqerise per periudhen financiare 1 Janar 2013 – 31 Dhjetor 2013.

PRANDAJ,

Ne baze te Nenit 127, 135/dh, 135/ç dhe 145 te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Nenit 7.2, 7.3, 8.1 shkronja d), f) dhe g) dhe neni 9 dhe 10 i Statutit te Shoqerise, me unanimitet te anetareve te saj, Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te Shoqerise

VENDOSI:

- i) Te miratojne llogarite financiare te Shoqerise per periudhen financiare 1 Janar 2013 – 31 Dhjetor 2013 te paraqitura nga Administratori i Shoqerise, ashtu sic jane paraqitur ne "Raportin e Auditoreve te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare per vitin qe mbaron me 31 Dhjetor 2013".
- ii) Llogarite financiare te miratuara dhe te nenshkruara do t'i bashkengjiten vendimit te kesaj mbledhjeje.
- iii) Duke qene se rezerva ligjore e nevojshme e Shoqerise ka arritur shumen prej 568,987,434 LEKE (peseqind e gjashtedhjetë e tete milione e nenteqind e tetedhjetë e shtate mije e katerqind e tridhjetë e kater) e cila perben 10% te kapitalit te nenshkruar te Shoqerise, atehere nuk do te krijohet rezerve ligjore e re.
- iv) Fitimi kumulativ deri me daten 31 Dhjetor 2013, me saktësisht shuma prej 16,919,322,469 LEKE (gjashtembëdhjetë miliardë e nenteqind e nentembëdhjetë milion e treqind e njëzetë e dy mije e katerqind e gjashtedhjetë e nente) **nuk** do t'u shperndahet aksionereve dhe do te mbahet nga Shoqeria si "fitime te pashperndara" per t'u perdorur per aktivitetin e ardhshem ekonomik te Shoqerise.
- v) Te miratoje caktimin e PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. si auditore te pavarur te Vodafone Albania Sh.a. duke filluar qe nga data 21 Maj 2014.

Sa me siper u miratua me unanimitet nga aksioneret e pranishem.

Duke mos patur ceshtje te tjera per te diskutuar, mbledhja u mbyll.

Perfaqesues te
Vodafone Europe B.V.:

[nenshkrimi] [nenshkrimi]

Erik de Rijk

Perfaqesues te
Vodafone Panafon International Holdings B.V.:


[nenshkrimi] [nenshkrimi]

Erik de Rijk

Dennis Kraan

Erik de Rijk
Dennis Kraan



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 303 Rep.



VERTETIM

Vertetoj nenshkrimin e perkthyeses Elona Cano,banuese ne Tirane, e njohur personalishte prej meje,e cila me deklaroi se perktheu njesoj me originalin dokumentin bashkangjitur dokument "Deklarate dhe Procesverbal per Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve date 22.07.2014", nga faqja 1 deri ne faqen 5 , pjese e dokumentit bashkalidhur, nga gjuha Angleze ne gjuhen shqipe.

Tirana, 25 /07/.2014



NOTARE
MIMOZA I. SADUSHAJ

VODAFONE ALBANIA sh.a.



**Raporti i Auditorit të Pavarur
dhe Pasqyrat e Veçanta Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

PËRMBAJTJA



	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar	2
Pasqyra e veçantë e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse	3
Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapital	4
Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parash	5
Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare	6-36

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar aksionarëve të Vodafone Albania sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të bashkëngjitura të Vodafone Albania sh.a., të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013 dhe pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Veçanta

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të veçanta. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të veçanta nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të veçanta. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare të veçanta, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethanat të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të veçanta.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Vodafone Albania sh.a. më 31 dhjetor 2013 si dhe performancën financiare dhe rrjedhjen e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Albania sh.p.k.

15 maj 2014

Tiranë, Shqipëri

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/ta/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Elvis Ziu
Partner Angazhimi

Vodafone Albania sh.a.

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
AKTIVE			
Aktive afatgjata			
Investime në filiale	5	20,000,000	-
Aktive afatgjata materiale, neto	6	13,446,072,079	13,114,745,518
Aktive afatgjata jo-materiale, neto	7	4,434,233,402	5,102,371,381
Aktive tatimore të shtyra	8	782,672,730	536,605,720
Totali i aktiveve afatgjata		18,682,978,211	18,753,722,619
Aktive afatshkurtra			
Inventarët, neto	9	176,454,415	149,263,783
Llogari të arkëtueshme, neto	10	998,862,983	1,451,416,036
Llogarit të tjera të arkëtueshme, neto	11	1,913,514,680	1,688,087,506
Parapagime dhe shpenzime për t'u shpërndarë		428,636,819	402,606,834
Mjete monetare në arkë dhe bankë	12	4,747,029,729	5,466,065,810
Totali i aktiveve afatshkurtra		8,264,498,626	9,157,439,969
TOTALI I AKTIVEVE		26,947,476,837	27,911,162,588
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Kapitali			
Kapitali aksionar	13	5,689,874,341	5,689,874,341
Rezerva ligjore	14	568,987,434	568,987,434
Fitimi i pashpërndarë		16,919,322,469	15,095,780,758
Totali i kapitalit		23,178,184,244	21,354,642,533
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	15	1,990,287,249	4,818,617,786
Llogari të tjera të pagueshme	16	489,555,979	578,253,963
Detyrime tatimore afatshkurtra	18	39,916,825	53,225,720
Tatime të tjera dhe sigurime shoqërore të pagueshme		17,521,650	17,144,668
Provizione për taksa dhe çështje gjyqësore	19	603,224,507	507,282,937
Të ardhura për t'u shpërndarë	20	628,786,383	581,994,981
Totali i detyrimeve afatshkurtra		3,769,292,593	6,556,520,055
TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		26,947,476,837	27,911,162,588


Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Vodafone Albania sh.a. më 31 mars 2014 dhe u nënshkruan nga:

Dietlof Mare



Drejtor i Përgjithshëm

Alexandre Mauricio



Drejtor i Departamentit të Financës

Shënimet mbi pasqyrat e veçanta financiare nga 1 deri në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

Vodafone Albania sh.a.**Pasqyra e veçantë e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumatat janë shprehur në Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura	21	18,348,550,161	23,169,066,615
Kosto e shitjes	22	(12,142,876,110)	(15,057,920,495)
Fitimi bruto		6,205,674,051	8,111,146,120
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	23	(1,262,709,277)	(1,418,063,432)
Shpenzimet administrative	24	(1,140,754,411)	(1,004,031,164)
(Shpenzime) / të ardhura të tjera operative, neto	25	(281,229,589)	8,429,895
Të ardhurat nga veprimtaritë e shfrytëzimit		3,520,980,774	5,697,481,419
Të ardhura nga interesi, neto		101,388,398	94,022,104
(Humbje) / fitime nga kursi i këmbimit, neto		(25,785,052)	9,294,826
Shpenzime interesi për detyrimet tatimore		(32,476,227)	(29,134,760)
Të ardhura financiare, neto		43,127,119	74,182,170
Fitimi neto para tatimit		3,564,107,893	5,771,663,589
Tatimi mbi fitimin	26	(271,242,428)	(752,516,286)
Fitimi neto për vitin		3,292,865,465	5,019,147,303
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse		3,292,865,465	5,019,147,303

Shënimet mbi pasqyrat e veçanta financiare nga 1 deri në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

Vodafone Albania sh.a.

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2012	5,689,874,341	568,987,434	13,458,375,188	19,717,236,963
Dividendët e paguar gjatë vitit	-	-	(3,381,741,734)	(3,381,741,734)
Fitimi i vitit	-	-	5,019,147,304	5,019,147,304
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2012	5,689,874,341	568,987,434	15,095,780,758	21,354,642,533
Dividendët e paguar gjatë vitit	-	-	(1,469,323,754)	(1,469,323,754)
Fitimi i vitit	-	-	3,292,865,465	3,292,865,465
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	5,689,874,341	568,987,434	16,919,322,469	23,178,184,244

SHËNIMET MBI PASQYRAT E VEÇANTA FINANCIARE
nga 1 deri në 31 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare të veçantë.

Shënimet mbi pasqyrat e veçanta financiare nga 1 deri në 31 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare të veçantë.

Vodafone Albania sh.a.**Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)*

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE		
Fitimi para tatimit	3,564,107,893	5,771,663,589
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvierësime dhe amortizime	3,883,857,293	3,671,010,257
Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve afatgjata materiale	-	27,547,955
Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve afatshkurtra, neto	146,007,018	292,290,295
Rimarrje nga provigjonet për detyrime të ardhshme	32,476,227	(274,570,528)
Të ardhura neto nga interesi	(101,388,398)	(94,200,139)
Humbje / (fitime) nga kursi i këmbimit	25,785,052	(9,294,826)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative përpara lëvizjeve në kapitalin punues	7,550,845,085	9,384,446,603
 (Rritje) / pakësim në gjendjen e inventarëve	(19,676,100)	78,865,437
Pakësim / (ritje) në llogaritë e arkëtueshme	280,733,048	(1,406,948,985)
(Pakësim) / rritje në llogaritë e pagueshme	(2,882,889,311)	1,822,415,415
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	4,929,012,722	9,878,778,470
 Tatim fitimi i paguar	(687,282,519)	(651,049,803)
Interesi i paguar	-	-
Interesi i arkëtuar	101,388,398	94,200,139
Paraja neto e gjeneruar nga aktiviteti operativ	4,343,118,601	9,321,928,806
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE		
Blerje e aktiveve afatgjata	(3,553,690,086)	(2,918,878,239)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	6,644,210	455,345
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese	(3,547,045,876)	(2,918,422,894)
PARAJA E PËRDORUR NË AKTIVITETET FINANCUESE		
Investime në filiale	(20,000,000)	-
Dividendët e paguar	(1,469,323,754)	(3,381,741,734)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financues	(1,489,323,754)	(3,381,741,734)
 (Pakësim) / rritje neto e mjeteve monetare në arkë dhe në bankë	(693,251,029)	3,021,764,178
(Humbje) / fitime nga kursi i këmbimit	(25,785,052)	9,294,826
Mjete monetare në arkë dhe në bankë në fillim të vitit	5,466,065,810	2,435,006,806
Mjete monetare në arkë dhe në bankë në fund të vitit	4,747,029,729	5,466,065,810

Shënimet mbi pasqyrat e veçanta financiare nga 1 deri në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

Vodafone Albania sh.a.

Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

1. TË PËRGJITHSHME

Vodafone Albania sh.a. ("Shoqëria") u krijua si një shoqëri anonime me kapital aksionar më datë 9 maj 2001 dhe u regjistrua në regjistrin e shoqërive të themeluara në të njëjtën ditë me një kapital të nënshkruar prej 100,000 Euro të ndarë në 1,000 aksione me vlerë nominale 100 Euro. Këto aksione zotëroheshin fillimisht në masën 51% nga "Vodafone International Holdings" B.V. dhe 49% nga "Panafon International Holdings" B.V.

Gjatë një mbledhjeje të jashtëzakonshme të aksionarëve mbajtur në datën 20 shtator 2001 aksionarët e Shoqërisë vendosën rritjen e kapitalit aksionar në 43,740,000 Euro të ndarë në 437,400 aksione me vlerë nominale 100 Euro secili, nga të cilat 223,074 aksione zotëroheshin nga "Vodafone International Holdings" B.V. dhe 214,326 aksione zotëroheshin nga "Vodafone Panafon International Holdings" B.V., dhe në këtë mënyrë përqindjet në kapital mbetën të njëjta.

Më 18 qershor 2007 aksionarët e Shoqërisë nënshkruan një marrëveshje për shitjen e aksioneve. Sipas marrëveshjes 4,347 aksione të zakonshme me vlerë nominale 100 Euro secili u transferuan nga "Vodafone International Holdings" B.V. tek "Vodafone Panafon International Holdings" B.V., duke ndryshuar përqindjet në masën 50% me 50% për secilën palë.

Më 26 qershor 2009 "Vodafone International Holdings" B.V. zotëruesi i 218,700 aksioneve të zakonshme me vlerë 21,870,000 Euro në Vodafone Albania, transferoi të gjithë pjesën e saj të aksioneve tek "Vodafone Europe" B.V.

Si rrjedhim, që nga 26 qershor 2009, struktura zotëruese e aksioneve ndryshoi, 50% zotërohen nga "Vodafone Panafon International Holdings" B.V dhe 50% nga "Vodafone Europe" B.V.

Shoqëria është operatori i dytë i licensuar i telefonisë celulare në Shqipëri dhe ka filluar aktivitetin e saj tregtar që prej datës 3 gusht 2001.

2. ZBATIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA

2.1 Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën aktuale:

- **SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara"** publikuar nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 10 zëvendëson udhëzimet e konsolidimit në SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale të Konsoliduara dhe KIS-12 Konsolidimi - Njësitë ekonomike për qëllime të veçanta duke futur në një model të vetëm konsolidimin e të gjitha subjekteve në bazë të kontrollit, pa marrë parasysh natyrën e të investuarit (p.sh., nëse njësitë ekonomike është e kontrolluar me anë të së drejtës së votimit të investitorëve apo përmes marrëveshjeve të tjera kontraktuese siç është e zakonshme në subjektet me qëllim të veçantë). Sipas SNRF 10, kontrolli është i bazuar në faktin nëse një investitor ka 1) pushtet mbi të investuarit; 2) ekspozim, ose të drejta, me të ardhura të ndryshueshme nga përfshirja e saj me të investuarit; dhe 3) aftësia për të përdorur fuqinë e saj mbi të investuarit që të ndikojnë në shumën të ardhurave (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

2. ZBATIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITESUARA (VAZHDIM)

2.1 Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale (vazhdim)

- **SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta”** publikuar nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 11 paraqet kërkesat e reja kontabël për marrëveshjet e përbashkëta, duke zëvendësuar SNK 31 Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta. Mundësia për të aplikuar metodën e konsolidimit proporcional për njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht është hequr. Përveç kësaj, SNRF 11 eliminon aktivet e kontrolluara bashkërisht dhe bën dallim midis operacioneve të përbashkëta dhe ndërmarrjeve të përbashkëta. Një operacion i përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët kanë të drejta mbi aktivet dhe detyrimet. Një ndërmarrje e përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët kanë të drejta të aktiveve neto (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese të Interesave në subjekteve të tjera”** – Të publikuara nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 12 do të kërkojë dhënie informacionesh shpjeguese të zgjeruara për njësitë e konsoliduara si dhe subjektet e pakonsoliduara në të cilat një njësi ekonomike ka përfshirje. Objektivi i SNRF 12 është që të kërkojë informacion në mënyrë që përdoruesit e pasqyrave financiare të mund të vlerësojnë bazën e kontrollit, çdo kufizim mbi aktivet dhe detyrimet e konsoliduara, ekspozimet e rrezikut që dalin nga përfshirja me subjekte të pakonsoliduara e të strukturuara dhe jo të kontrollueshme në përfshirjen e bartësve të interesit në aktivitetet e subjekte të konsoliduara (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013).
- **SNRF 13 “Matja e vlerës së drejtë”** publikuar nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 13 përcakton vlerën e drejtë, jep udhëzime se si përcaktohet vlera e drejtë dhe kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me matjet e vlerës së drejtë. Megjithatë, SNRF 13 nuk ndryshon kërkesat në lidhje me cilat objekte duhet të maten ose shpalosen me vlerën e drejtë. (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNK 27 (rishikuar në 2011) “Pasqyrat financiare të veçanta”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNK 28 (rishikuar në 2011) “Investime në filiale dhe shoqëri të përbashkëta”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNRF 1 “Adoptimi i SNRF-ve për herë të parë”**- Huatë Qeveritare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNRF 7 “Instrumentat financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese”**- Kompensimi i aktiveve dhe i detyrimeve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara”, SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta” dhe SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera”** – Udhëzim për kalimin (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”** – Paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2012),
- **Ndryshime në SNK 19 “Përfitimet e punonjësve”** – Përmirësime të kontabilizimit për përfitimet pas punësimit të punonjësve (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në disa standarde “Përmirësime në SNRF (cikli 2009 - 2011)”** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 1, SNK 1, SNK 16, SNK 32, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **KIRFN 20 “Shpenzimet e nxjerrjes në fazën e prodhimit të një sipërfaqeje miniere”** – (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013).

Aplikimi i këtyre ndryshimeve të standardeve dhe interpretimeve ekzistuese nuk ka sjellë ndryshim në politikat kontabël të Shoqërisë.

2. ZBATIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

2.2 Standarde dhe Interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e raportimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ishin publikuar, por nuk ishin ende efektive.

- **SNRF 9 "Instrumentat Financiare" dhe ndryshimet e mëvonshme** të publikuara nga BSNK më 12 nëntor 2009. Më 28 tetor 2010, BSNK ribotoi SNRF 9, duke përfshirë kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare dhe duke mbajtur nga SNK 39 kërkesat për çregjistrimin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare. Më 19 nëntor 2013 BSNK publikoi një paketë ndryshimesh në kërkesat e kontabilitetit për instrumentat financiare. Standardi përdor një qasje të vetme për të përcaktuar nëse një aktiv financiar matet me koston e amortizuar apo me vlerën e drejtë, duke zëvendësuar rregullat e shumta në SNK 39. Metodologjia e SNRF 9 bazohet në faktin se si një njësi ekonomike manaxhon instrumentat e saj financiare (sipas modelit të biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhës së parasë së aktiveve financiare. Standardi i ri gjithashtu do të kërkojë që të përdoret një metodë zhvlerësimi, duke zëvendësuar shumë metoda të ndryshme të zhvlerësimit të SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare paraqesin problemin e luhatshmërisë në fitim ose humbje që rrjedh nga një emetues që zgjedh të masë borxhin e vet me vlerën e drejtë. BSNK vendosi të mbajë matjen e koston ekzistuese të amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke kufizuar ndryshim me atë që kërkohet për të trajtuar problemin e vet të kredisë. Me kërkesat e reja, një njësi ekonomike e cila zgjedh të matë një detyrim me vlerën e drejtë, do ta paraqesë pjesën e ndryshimit me vlerën e drejtë të tij, për shkak të ndryshimeve në vetë rrezikun e kredisë të njësisë ekonomike në seksionin e të ardhurave të tjera përmbledhëse të pasqyrës së të ardhurave, jo brenda fitimit ose humbjes. Ndryshimet nga muaji nëntor 2013 do të sjellin në fuqi një rishikim të konsiderueshëm të kontabilitetit që do të lejojë njësitë ekonomike për të pasqyruar më mirë aktivitetet e tyre të manaxhimit të riskut në pasqyrat financiare. Kjo i lejon ndryshimet për të paraqitur çështjen "borxhi i vet" që është e përfshirë tashmë në SNRF 9 Instrumentat Financiare dhe që do të aplikohet në mënyrë të izoluar pa patur nevojë për të ndryshuar ndonjë tjetër për instrumentat financiare. Ajo gjithashtu heq datën e detyrueshme në fuqi 1 janar 2015 të SNRF 9, për të siguruar kohë të mjaftueshme për hartuesit e pasqyrave financiare për të bërë kalimin në kërkesat e reja (Më 20 shkurt 2014, BSNK vendosi që data efektive për SNRF 9 do të jetë 1 janar 2018).
- **SNRF 14 "Llogaritë e Shtyra Rregullatore"** (efektive për periudhën vjetore më ose pas 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" dhe SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"** – Shoqëritë investuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e Punonjësve"** – Planet e përcaktuara të përfitimit: Kontributet e punonjësve (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në SNK 32 "Instrumentat financiare: paraqitja"** – Kompensimi i aktiveve dhe i detyrimeve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 36 "Rënia në vlerë e aktiveve"** – Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme të aktiveve jo financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 39 "Instrumentat financiare: Njohja dhe Matja"** – Novacioni i derivativeve dhe vazhdimësia e kontabilitetit mbrojtës (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshimet në disa standarde "Përmirësimet në SNRF (cikli 2010-2012)"** të cilat rezultojnë nga projektet e përmirësuar vjetore të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014),

2. ZBATIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

2.2 Standarde dhe Interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

- **Ndryshimet në disa standarde "Përmirësimet në SNRF (cikli 2011-2013)"** të cilat rezultojnë nga projektet e përmirësuara vjetore të SNRF (IFRS 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014),
- **KIRFN 21 "Taksimi"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014).

Shoqëria ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Drejtimi parashikon se aplikimi i këtyre standardeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e zbatimit fillestar.

Vodafone Albania sh.a.

Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL

3.1 Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Përgatitja e pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në vlerat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve dhe shënimet shpjeguese të aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në datën e pasqyrave financiare të veçanta si dhe vlerat e të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara gjatë periudhës së raportimit. Diskutimi rreth vlerësimeve të rëndësishme kontabël të Shoqërisë jepet në shënimin 4 "Vlerësimet e rëndësishme kontabël". Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të përlogaritura. Përlogaritjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e përlogaritjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën ato rishikohen, nëse ky rishikim ndikon vetëm në atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme kur rishikimi ndikon si periudhën aktuale, ashtu dhe ato të ardhshme.

Shoqëria nuk ka paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara sepse i plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme në përputhje me SNRF 10:

- është një filial tërësisht në pronësi ose një filial pjesërisht në pronësi të një njësie ekonomike tjetër dhe pronarët e saj të tjerë, duke përfshirë edhe ato që nuk kanë të drejtë të votojnë, janë informuar, dhe nuk kundërshtojnë, mosparaqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara nga Shoqëria mëmë,
- borxhi i saj ose instrumentat e kapitalit nuk tregtohen në një treg publik (në bursa të vendit apo të huaja ose në një treg mbi banak, duke përfshirë tregjet lokale dhe rajonale),
- nuk ka paraqitur, as nuk është në proces të dorëzimit të pasqyrave të saj financiare me një komision të letrave me vlerë ose ndonjë organizëm tjetër rregullator me qëllim emetimin e ndonjë klase të instrumentave në një treg publik, dhe
- shoqëria mëmë përfundimtare ose e ndërmjetme përgatit pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik të cilat janë në përputhje me SNRF-të.

3.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të veçanta bashkëngjitur janë përgatitur mbi bazën e koston historike. Kosto historike është zakonisht e bazuar mbi vlerën e drejtë të konsideratës së dhënë në shkëmbim të aktiveve.

Vlerat në pasqyrat financiare janë të pasqyruara në Lek shqiptare ("LEK"), që është monedha e vendit ku Shoqëria kryen aktivitetin e saj.

Politikat kontabël janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura dhe janë përmbledhur si më poshtë.

3.3 Përmbledhje e politikave bazë kontabël

3.3.1 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivitet afatgjata jo-materiale kanë një jetëgjatësi të caktuar dhe përbëhen nga liqensat e aktivitetit dhe programet e kompjuterave të blera me kosto direkte të kapitalizuara. Kostot që lidhen me mirëmbajtjen e programeve të kompjuterave njihen si shpenzime mirëmbajtje në periudhën kur ndodhin.

Liqensa e aktivitetit pasqyrohet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Periudha e amortizimit është 15 vjet dhe përfaqëson afatin e liqensës.

Vodafone Albania sh.a.

Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.3.1 Aktivet afatgjata jo-materiale (vazhdim)

Amortizimi ngarkohet në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse me bazë lineare gjatë periudhës së jetëgjatësisë së vlerësuar nga data e fillimit të shërbimit në rrjet.

Aktivitet e tjera jo-materiale pasqyrohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Amortizimi ngarkohet në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse në bazë lineare gjatë periudhës së vlerësuar të këtyre aktiveve nga data kur ato vihen në përdorim.

3.3.2 Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale janë paraqitur në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar me kosto duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë.

Aktivitet në ndërtim mbahen me kosto minus humbjet nga rënia në vlerë. Zhvlerësimi për këto pajisje fillon në momentin kur ato janë gati për përdorim sipas qëllimit të tyre.

Kosto e aktiveve afatgjata materiale të tjera minus vlerën e përlllogaritur të mbetur në fund të përdorimit, zhvlerësohen në bazë lineare gjatë jetëgjatësisë së pritshme të tyre, si më poshtë:

Kategoria	Norma e zhvlerësimit	Jetëgjatësia e aktivitet
Pajisjet e rrjetit të telefonisë celulare	12.5%	8 vjet
Të tjera makineri e pajisje	12.5% - 33.3%	3 - 8 vjet

Kosto e aktiveve afatgjata materiale përfshin kostot e drejtëpërdrejta shtesë që ndodhin gjatë blerjes dhe instalimit. Çdo fitim apo humbje nga shitja ose nxjerrja nga përdorimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet si diferencë ndërmjet çmimit të shitjes dhe vlerës kontabël të aktivitet dhe njihet në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse.

3.3.3 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale që të përcaktojë nëse këto aktive kanë ndonjë të dhënë për humbje nga rënia në vlerë. Nëse një e dhënë e tillë ekziston, vlera e rikuperueshme e aktivitet vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet vlera e humbjes nga rënia në vlerë. Në qoftë se nuk është e mundur vlerësimi i vlerës së rikuperueshme të një aktivitet të vetëm, Shoqëria vlerëson vlerën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare së cilës i përket ky aktivitet.

Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, fluksi i ardhshëm monetar skontohe duke përdorur një normë skontimi para tatimit, që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktiveve për të cilat fluksi i ardhshëm i parasë nuk ka qenë i korrigjuar.

Nëse shuma e rikuperueshme e një aktivitet apo e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare vlerësohet më pak se vlera kontabël, atëherë kjo e fundit zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Kur humbja nga rënia në vlerë anulohet pasi është njohur në periudhat e mëparshme, vlera kontabël e aktivitet apo njësisë gjeneruese të mjeteve monetare rritet sa vlera e rishikuar e shumës së rikuperueshme, por nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej nëse nuk do të ishte njohur një humbje në vlerë në periudhat e mëparshme për aktivitet apo njësinë. Anullimi i humbjes nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Vodafone Albania sh.a.

Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.3.4 Instrumentat financiarë

Shoqëria ka vetëm instrumenta financiare jo-derivative, të përbërë nga llogari të tregtueshme dhe të arkëtueshme, para dhe ekuivalentet e saj si dhe llogari të tjera të pagueshme.

Njohja fillestare

Instrumentat financiarë jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë, ndërsa për instrumentat jo në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, plus ndonjë kosto transaksioni i cili i atribuohet direkt. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Matja e mëpasshme

Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative janë matur siç është përshkruar më poshtë për secilin instrument.

Çregjistrimi

Aktivitet financiarë çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë në flukset e mjeteve monetare nga aktivitet financiarë kanë skaduar ose nëse Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë tjetër, pa mbajtur kontrollin apo rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet e zakonshme dhe shitja e aktiveve financiare llogariten në datën e tregtimit, p.sh., data që Shoqëria angazhohet për të blerë ose shitur aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e shoqërisë të specifikuar në kontratë, skadojnë ose janë hequr apo anuluar.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlerën nominale të zvogëluar nga provigjionet për shumat e vlerësuara si jo të rikuperueshme. Shumat e vlerësuara si jo të rikuperueshme bazohen në vjetërsinë e këtyre llogarive të arkëtueshme dhe në eksperiencën historike. Klientët individë eliminohen kur Drejtimi i vlerëson si jo të arkëtueshëm.

Para dhe ekuivalentët e saj

Para dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe në banka, dhe investime të tjera afatshkurtra shumë likuide që janë lehtësisht të konvertueshme dhe i nënshtrohen një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë. Para dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme nuk mbartin interes dhe janë dhënë në vlerë nominale.

Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet si i rënë në vlerë nëse evidenca objektive tregon se një apo më shumë ngjarje kanë pasur një efekt negativ në flukset e ardhshme të parasë për aktivin. Një humbje nga rënia në vlerë e një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të vlerësuara të mjeteve monetare të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje. Humbja nga rënia në vlerë rimerret nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur. Rrimarrja njihet në fitim ose humbje.

Vodafone Albania sh.a.

Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.3.4 Instrumentat financiare (vazhdim)

Rënia në vlerë e aktiveve financiare (vazhdim)

Rënia në vlerë e llogarive të dyshimta përfshin zhvlerësime specifike dhe të përgjithshme. Zhvlerësimi i përgjithshëm përfshin të gjitha borxhet me rrezik të lartë dhe zhvlerësimin e duhur kundër borxhit në kategori të tjera që nuk është vlerësuar individualisht. Shuma e zhvlerësimit lidhet me llogaritë për tu arkëtuar nga klientët me kontratë.

3.3.5 Inventarët

Inventarët pasqyrohen me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot përfshijnë materiale direkte, dhe ku është e aplikueshme, kostot e punës dhe shpenzimet indirekte që kanë bërë të mundur sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme përfaqëson çmimin e shitjes së vlerësuar për inventarët minus kostot e përfundimit dhe kostot e nevojshme të shitjes.

3.3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë kryesisht shitjet e shërbimeve të telekomunikacionit të klientët dhe rrjetet celulare të tjera. Të ardhurat maten me vlerën reale të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme. E ardhura pakësohet nga kthimet e vlerësuara të klientëve, zbritjet dhe skonto të tjera të ngjashme.

E ardhura nga telefonia celulare përfshin shumat e faturuara klientëve lidhur me tarifat mujore të aksesit, kohëzgjatjes së bisedës, mesazheve, shërbime të tjera celulare, përfshi këtu shërbime të dhënash dhe informacioni, akses roaming dhe interkoneksioni për të lidhur përdoruesit e linjave të tjera fikse dhe celulare me rrjetin e Shoqërisë.

E drejta e përdorimit dhe koha e bisedës së përdorur nga klientët me kontratë faturohen dhe regjistrohen në fund të çdo muaji dhe njihen si të ardhura që lidhen me periudhën e përdorimit; e ardhura e pafaturuar që vjen nga shërbimet e përfutuara nga periudha e faturimit deri në fund të periudhës regjistrohet si e ardhur e konstatuar, dhe të ardhurat për shërbime që do të kryhen pas datës së raportimit regjistrohen si të ardhura për t'u shpërndarë. E ardhura nga shitja e kreditit të parapaguar shtyhet deri sa klienti e përdor këtë kohë bisede të blerë, apo kur kreditit i mbaron afati.

Të ardhura të tjera nga telefonia celulare përfshin kryesisht shitjen e pajisjeve, të cilat njihen kur dorëzohen të klientët, dhe e ardhura nga lidhja e klientit. E ardhura e lidhjes së klientit njihet bashkë me të ardhurën nga pajisja, deri kur e ardhura e pajisjes dhe ajo e lidhjes nuk e kalojnë vlerën e drejtë të pajisjes së dorëzuar të klientit. E ardhura nga lidhja me klientin që nuk njihet si më sipër, shtyhet në kohë dhe shpërndahet në periudhën në të cilën pritet që shërbimet do t'i ofrohen klientit.

Të ardhurat nga shërbimet e të dhënave dhe informacionit njihen atëherë kur Shoqëria ka kryer shërbimin dhe, sipas natyrës së shërbimit, njihet ose si vlerë bruto faturuar të klientit, ose si vlerë e arkëtueshme nga Shoqëria si një komision për mundësimin e shërbimit.

3.3.7 Qiraja

Pagesat e qirave të pagueshme nën një kontratë qiraje operative i ngarkohen pasqyrës së veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse në bazë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Përfitimet e marra dhe për t'u marrë si një stimul për të hyrë në një qira operative shpërndahen sipas metodës lineare përgjatë afatit të qirasë.

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.3.8 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetare në monedhë të huaj rikonvertohen në Lek me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Zërat jo-monetare, që maten me koston historike në monedhë të huaj, nuk konvertohen.

Diferencat nga kursi i këmbimit, që vijnë nga shlyerja e këtyre zërave monetare dhe nga rikonvertimi i tyre, përfshihen në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën.

3.3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin paraqet shumën e tatimit aktual të pagueshëm dhe atij të shtyrë.

Tatimi aktual i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbështetet mbi fitimin e tatueshëm të vitit. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vite të ndryshme ose që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme. Detyrimi i Shoqërisë për tatim fitimin aktual llogaritet duke përdorur normën lokale të tatimit në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë është tatimi që pritet të paguhet apo rikuperohet në të ardhmen dhe vjen si rrjedhojë e diferencave të përkohëshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare dhe bazës korresponduese fiskale përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm.

Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohëshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë fitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferencat e përkohëshme të zbritshme. Vlera kontabël e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tatimore të realizohen. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet duke përdorur normat tatimore që pritet të zbatohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet dhe aktiv i realizohet, bazuar në normat tatimore të miratuara ose që priten të miratohen me siguri në datën e raportimit.

Tatimi ngarkohet apo kreditohet në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse, përveç kur është i lidhur me zërat e ngarkuar direkt në kapital, në të tilla raste tatimi është gjithashtu pjesë e kapitalit.

3.3.10 Kosto e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse në periudhën kur kanë ndodhur, përveç rasteve kur Shoqëria ka blerë apo është në procesin e blerjes së një aktivi kualifikues, rast në të cilin kostot e huamarrjes, të lidhura direkt me blerjen apo ndërtimin e aktivit, kapitalizohen.

3.3.11 Provigjonet

Provigjonet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarjeje të ndodhur më parë dhe është e mundur që të kërkohej që ky detyrim të shlyhet nga Shoqëria. Provigjonet maten me vlerësimin më të mirë të bërë nga Drejtimi për shpenzimin që duhet për të mbyllur detyrimin në datën e raportimit dhe skontohej në vlerën aktuale kur efekti është material.

Kur disa, ose të gjitha të mirat ekonomike të nevojshme për të shlyer një provigjon, pritet të mbulohen nga një palë e tretë, pjesa e arkëtueshme njihet si aktiv në qoftë se është e sigurt që rimbursimi do të përfitohet dhe shumën e arkëtueshme mund të matet në mënyrë të besueshme.

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.3.12 Investimet në filiale

Filialet janë njësi ekonomike të kontrolluara nga Shoqëria. Kontrolli ekziston kur Shoqëria ka pushtet mbi të investuarit; është e ekspozuar, ose ka të drejta, për kthimin nga përfshirja e saj me të investuarit; dhe ka aftësinë për të përdorur fuqinë e saj për të ndikuar të ardhurat e saj. Duke qenë se Shoqëria zotëron 100% të aksioneve të filialeve, kontrolli supozohet të ekzistojë. Investimet në filiale janë të regjistruara me kosto në pasqyrat financiare të veçanta. Shoqëria njihet një dividend nga një filial në fitim ose humbje në pasqyrat financiare të veçanta kur është vendosur e drejta për të marrë dividendin.

4. GJYKIME KONTABËL DHE BURIMET KRYESORE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT

Shoqëria përgatit pasqyrat financiare të veçanta në përputhje me SNRF, aplikimi i të cilave, shpesh, kërkon të bëhen vlerësime nga Drejtimi i Shoqërisë gjatë raportimit të pozicionit financiar dhe rezultateve të Shoqërisë. Në zbatim të SNRF, Drejtimit i kërkohet të aplikojë këto politika bazë kontabël me qëllimin e prezantimit sa më të drejtë të situatës financiare të Shoqërisë, performancës financiare dhe rrjedhjes së parasë.

Në përcaktimin dhe përdorimin e politikave bazë kontabël, gjykimi shpesh kërkohet për ato raste në të cilat zgjedhja e një politike specifike, përlllogaritje kontabël ose supozimit të bërë mund të ndikojë në mënyrë materiale në rezultatin e raportuar ose për gjendjen neto të aktiveve të Shoqërisë, ndërkohë që më pas mund të vendoset që një zgjedhje tjetër do të kishte qenë më e përshtatshme.

Drejtimi konsideron përlllogaritjet kontabël dhe supozimet e bëra më poshtë si vlerësime kontabël kritike dhe ka përshkruar shpjegime për secilën si më poshtë.

4.1 Vlerësimi për rënien në vlerë

Rikuperimi i vlerës së aktiveve është një fushë që përfshin gjykimin e Drejtimit, që kërkon vlerësimin nëse vlera neto e aktiveve mund të mbështetet nga vlera aktuale neto e rrjedhave të ardhshme të parasë të gjeneruara nga këto aktive duke përdorur projeksionet e rrjedhave të parasë të skontuara me një normë të përshtatshme. Për llogaritjen e vlerës aktuale neto të rrjedhave të ardhshme të parasë nevojitet të bëhen disa supozime për çështjet e pasigurta, si më poshtë.

Sipas SNRF nevojitet që Drejtimi të kryejë një test vjetor për rënien në vlerë të aktiveve me jetëgjatësi të papërcaktuar dhe për aktivet me jetëgjatësi të përcaktuar, të testojë nëse ka rrethana që tregojnë se vlera kontabël neto e një aktivi mund të mos jetë e rikuperueshme. Drejtimi i Shoqërisë rishikon aktivet materiale dhe jo-materiale të paktën një herë në vit për të vendosur nëse nevojitet një rishikim i plotë për rënien në vlerë.

Lejimi për zhvlerësim të llogarive të dyshimta

Shoqëria shqyrton llogaritë e arkëtueshme për të vlerësuar zhvlerësimin në baza mujore. Për të përcaktuar nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (në fitim dhe humbje), Drejtimi gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon se ka një ulje të ndjeshme në flukset e vlerësuar të mjeteve monetare të ardhshme nga llogaritë e arkëtueshme. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të debitorëve të një grupi, ose kushte ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me përkeqësimin e aktiveve në grup. Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike për humbjet nga aktivet me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe prova objektive të zhvlerësimit, me ato në portofolin kur përcaktohen flukset e ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar sasinë dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferencat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

4. GJYKIME KONTABEL DHE BURIMET KRYESORE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT (VAZHDIM)

4.2 Vlerësimi i jetëgjatësisë së aktiveve jo-materiale

Jetëgjatësia e përdorur për amortizimin e aktiveve jo-materiale është e lidhur me performancën e ardhshme të aktivitetit dhe me vlerësimin e Drejtimit për periudhën në të cilën aktiviteti do të gjenerojë të ardhura. Baza për përcaktimin e jetëgjatësisë për pjesën më të rëndësishme të kategorive të aktiveve jo-materiale është si më poshtë:

Liçensat dhe tarifat spectrum

Jetëgjatësia e llogaritur bazohet, përgjithësisht, në afatin e liçensës, përveç në rastet kur supozohet një ripërtëritje me kosto të papërfillshme. Përdorimi i afatit të liçensës pasqyron periudhën në të cilën Shoqëria do të marrë përfitime ekonomike. Për liçensat e teknologjive specifike me supozimin e ripërtëritjes me kosto të ulët, jetëgjatësia ekonomike pasqyron periudhën gjatë së cilës Shoqëria pret të marrë të ardhura ekonomike nga kjo liçensë. Jetëgjatësia ekonomike rishikohet periodikisht, duke marrë parasysh faktorë si ndryshimi i teknologjisë. Historikisht, ndryshimet në jetëgjatësinë e aktiveve nuk kanë qënë materiale.

Programet kompjuterike të kapitalizuara

Jetëgjatësia është e përcaktuar nga Drejtimi në momentin e blerjes dhe vënies në punë dhe rishikohet rregullisht për pranueshmëri. Për liçensat e programeve kompjuterike, jetëgjatësia e tyre paraqet parashikimin e Drejtimit për periudhën gjatë së cilës Shoqëria pret të marrë përfitime ekonomike nga liçensa, por duke mos e tejkaluar afatin e liçensës. Për programet unike të Shoqërisë, jetëgjatësia e tyre vendoset në bazë të eksperiencës historike të produkteve të ngjashëm si dhe nga parashikimi i ngjarjeve të ardhshme, të cilat mund të ndikojnë në jetëgjatësinë e tyre, si për shembull ndryshime në teknologji.

4.3 Aktivët afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale gjithashtu përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të bazës së aktiveve të Shoqërisë, duke qenë rreth 50% (2012: 47%) të totalit të aktiveve të Shoqërisë. Për pasojë, këto vlerësime dhe supozime të bëra për të përcaktuar vlerën e tyre dhe zhvlerësimin përkatës, janë shumë të rëndësishme për pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë.

Vlerësimi i jetëgjatësisë

Shpenzimi periodik i zhvlerësimit është rrjedhojë e vlerësimit të jetëgjatësisë së pritur të aktivitetit si dhe nga parashikimi i vlerës së mbetur të aktivitetit në fund të jetëgjatësisë së tij. Zgjatja e jetëgjatësisë së pritur ose vlerës së mbetur do të rezultojë në uljen e shpenzimit në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Jetëgjatësia e aktiveve të Shoqërisë përcaktohet nga Drejtimi në momentin e blerjes dhe vënies në punë dhe rishikohet rregullisht për pranueshmëri. Jetëgjatësia vendoset në bazë të eksperiencës historike me aktive të ngjashme si dhe duke parashikuar ngjarje të ardhshme, të cilat mund të ndikojnë jetëgjatësinë e tyre, si ndryshime në teknologji. Për më tepër, infrastruktura e rrjetit amortizohet mbi një periudhë që zgjatet përtej skadencës së liçensës nën të cilën operatori ofron shërbime telekomunikacioni, vetëm në rast se ka ndonjë parashikim të arsyeshëm për ripërtëritjen ose ndonjë përdorim alternativ të aktivitetit në të ardhmen.

Historikisht, ndryshime në jetëgjatësinë e aktiveve nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme të normave të zhvlerësimit të përdorura nga Shoqëria.

Kapitalizimi i kostove

Kostoja përfshin çmimin total të blerjes dhe koston e punës së punonjësve të Shoqërisë, të cilat lidhen direkt me koston e ndërtimit, ose kur përfshijnë një pjesë të një departamenti i cili është marrë direkt me blerjen ose instalimin e aktivitetit afatgjatë material. Gjykimet e Drejtimit përfshihen në saktësimin e koston së brendshme për t'u kapitalizuar dhe shumat e përfshira.

Vodafone Albania sh.a.

Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

4. GJYKIME KONTABËL DHE BURIMET KRYESORE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT (VAZHDIM)

4.4 Tatimi

Tatimi i Shoqërisë mbi aktivitetet e zakonshme është shuma e tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Llogaritja e tatimit total të Shoqërisë përfshin një masë vlerësimi dhe gjykimi për rastet kur trajtimi i tatimit nuk mund të përcaktohet plotësisht deri me vendosjen nga autoriteti i tatim-taksave ose nëpërmjet një procesi ligjor.

Zgjidhja përfundimtare e këtyre rasteve mund të ndikojë në një fitim ose humbje materiale dhe / ose lëvizje në pasqyrën e rrjedhës së parasë. Tatimet potenciale të Shoqërisë detajohen në shënimin 26.

4.5 Njohja e aktiveve tatimore të shtyra

Njohja e aktiveve tatimore të shtyra bazohet në faktin nëse do të ketë fitim të tatueshëm të mjaftueshëm në të ardhmen nga i cili do të zbriten diferencat e përkohshme.

Njohja, për pasojë, përfshin vlerësimin në lidhje me performancën financiare të ardhshme të Shoqërisë. Diferencat historike midis fitimeve të tatueshme të parashikuara dhe atyre aktuale nuk kanë rezultuar në rregullime materiale në njohjen e aktiveve tatimore të shtyra.

4.6 Provigjoni i inventarëve

Në çdo datë raportimi, Shoqëria sigurohet se është kryer një provigjon i përshtatshëm për inventarin e vjetër, të dëmtuar dhe të vjetëruar. Një provigjon i inventarit është krijuar për vlerën kontabël të artikujve të inventarit më të vjetër se 365 ditë.

5. INVESTIME NË FILIALE

Investimet në filiale më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	31dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Vodafone M-PESA sh.p.k.	20,000,000	-
Total	20,000,000	-

Vodafone Albania sh.a. zotëron 100% të kapitalit aksionar të Vodafone M-Pesa sh.p.k. Kapitali aksionar i Vodafone M-Pesa sh.p.k. më 31 dhjetor 2013 ishte 20,000,000 LEK (2012: Lek 0). Vodafone M-PESA sh.p.k. është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 mars 2013 dhe u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 27 mars 2013.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE, NETO**

Aktive afatgjata materiale, neto më datë 31 dhjetor 2013 dhe 2012, janë paraqitur si më poshtë:

	Makineri dhe pajisje	Pajisjet e rrjetit të telefonisë celulare	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2012	982,913,879	40,508,231,621	41,491,145,500
Shtesa	140,997,792	2,748,908,247	2,889,906,039
Pakësime	(4,944,000)	(1,084,898,766)	(1,089,842,766)
Gjendja më 31 dhjetor 2012	1,118,967,671	42,172,241,102	43,291,208,773
 Shtesa	 227,623,686	 3,328,745,825	 3,556,369,511
Pakësime	(54,414,849)	(569,404,410)	(623,819,259)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	1,292,176,508	44,931,582,517	46,223,759,025
 Zhvlerësimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2012	(680,532,425)	(26,695,667,523)	(27,376,199,948)
Zhvlerësimi për vitin	(123,519,860)	(2,859,356,172)	(2,982,876,032)
Pakësime	4,462,274	629,319,627	633,781,901
Gjendja më 31 dhjetor 2012	(799,590,011)	(28,925,704,068)	(29,725,294,079)
 Zhvlerësimi për vitin	 (147,294,658)	 (2,994,036,042)	 (3,141,330,700)
Pakësime	30,485,151	416,467,361	446,952,512
Gjendja më 31 dhjetor 2013	(916,399,518)	(31,503,272,749)	(32,419,672,267)
 Rënia në vlerë			
Gjendja më 1 janar 2012	-	(877,773,714)	(877,773,714)
Rënia në vlerë	-	(28,987,458)	(28,987,458)
Përdorimi i rënies në vlerë	-	455,591,996	455,591,996
Gjendja më 31 dhjetor 2012	-	(451,169,176)	(451,169,176)
 Rënia në vlerë	 -	 (59,770,181)	 (59,770,181)
Përdorimi i rënies në vlerë	-	152,924,678	152,924,678
Gjendja më 31 dhjetor 2013	-	(358,014,679)	(358,014,679)
 Vlera kontabël neto			
Gjendja më 31 dhjetor 2012	319,377,660	12,795,367,858	13,114,745,518
 Gjendja më 31 dhjetor 2013	375,776,990	13,070,295,089	13,446,072,079

Provigjonet për rënie në vlerë përfaqësojnë provigjone të ngritura kundrejt antenave të ç'instaluara dhe pajisjeve të dëmtuara, për të cilat Shoqëria është duke përgatitur dokumentacionin e plotë për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre sikurse kërkohet nga autoritetet tatimore.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE, NETO (VAZHDIM)**

Shpenzimi për zhvlerësimin e vitit për aktivet afatgjata materiale është shpërndarë sipas funksionit si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Kostot e shitjes	2,994,036,042	2,859,355,953
Shpenzimet administrative	147,294,658	123,520,079
Totali	3,141,330,700	2,982,876,032

7. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE, NETO

Aktivët afatgjata jo-materiale, neto më datë 31 dhjetor 2013 dhe 2012, janë paraqitur si më poshtë:

	Liçensa e veprimtarisë	Aktive afatgjata jo-materiale të tjera	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2012	9,871,881,270	116,156,990	9,988,038,260
Shtesa	-	30,425,226	30,425,226
Gjendja më 31 dhjetor 2012	9,871,881,270	146,582,216	10,018,463,486
Shtesa	-	19,600,822	19,600,822
Gjendja më 31 dhjetor 2013	9,871,881,270	166,183,038	10,038,064,308
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2012	(4,148,621,329)	(79,336,552)	(4,227,957,881)
Amortizimi gjatë vitit	(662,978,414)	(25,155,810)	(688,134,224)
Gjendja më 31 dhjetor 2012	(4,811,599,743)	(104,492,362)	(4,916,092,105)
Amortizimi gjatë vitit	(661,167,000)	(26,571,801)	(687,738,801)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	(5,472,766,743)	(131,064,163)	(5,603,830,906)
Vlera kontabël neto			
Gjendja më 31 dhjetor 2012	5,060,281,527	42,089,854	5,102,371,381
Gjendja më 31 dhjetor 2013	4,399,114,527	35,118,875	4,434,233,402

Liçensa e veprimtarisë përfaqëson: a) shumën 38 milionë USD të paguar ndaj “Enti Rregullator i Telekomunikacionit” për operimin e shërbimit celular të telekomunikacionit për një periudhë 15 vjeçare. Amortizimi ka filluar prej datës 3 gusht 2001, që është data kur Shoqëria filloi veprimtarinë tregtare, dhe b) shumën prej 31.4 milionë Euro të paguar autoritetit rregullator (AKEP) për përdorimin e frekuencave që bëjnë të mundur shfrytëzimin e teknologjisë 3G për një periudhë 15 vjeçare deri më 31 dhjetor 2025. Amortizimi ka filluar që nga data 1 shkurt 2012.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***7. AKTIVE AFTAGJATA JO-MATERIALE, NETO (VAZHDIM)**

Shpenzimi i amortizimit për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor-2013 dhe 2012 është shpërndarë në qendrat e koston si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Kosto e shitjes	661,167,000	662,978,414
Shpenzimet administrative	26,571,801	25,155,810
Totali	687,738,801	688,134,224

8. AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA

Lëvizjet në detyrimet tatimore të shtyra janë si më poshtë:

	2013	2012
Aktive tatimore të shtyra		
Gjendja në fillim të vitit	536,605,720	547,481,054
Efekti në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse me normën e tatimit për vitin aktual (Shënimi 26)	246,067,010	(10,875,334)
Gjendja në fund të vitit	782,672,730	536,605,720

Aktivitet tatimore të shtyra janë analizuar si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Tatim fitimi i shtyrë që lind si rezultat ndryshimeve në zhvlerësim dhe amortizim	688,354,773	478,406,222
<i>Tatim fitimi i shtyrë nga diferencat e tjera të përkohshme:</i>		
Të ardhura të parapaguara (shitja e kartave)	94,317,957	58,199,498
Totali	782,672,730	536,605,720

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***9. INVENTARËT, NETO**

Gjendja e inventarëve, neto më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 analizohet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Aparate celulare	196,529,328	146,601,585
Aksesorë	14,058,290	42,799,513
Paketa lidhjeje	12,831,212	21,594,177
Karta rimbushëse	9,440,009	10,571,125
Karta VMCC me kontratë	4,431,339	4,925,274
Karta SIM zëvendësuese	2,011,739	2,175,377
Karta SIM me kontratë	904,355	1,819,808
Paketa promovuese	-	1,621,808
Mallra për rishitje	240,206,272	232,108,667
Provigjone për mallra gjendje inventari	(79,393,820)	(86,908,353)
Mallra për rishitje, neto	160,812,452	145,200,314
Inventarë të tjerë	15,641,963	4,063,469
Totali	176,454,415	149,263,783

Në inventarë të tjerë janë përfshirë materiale paketuuese dhe inventarë të ndryshëm.

Mallrat për rishitje janë raportuar duke marrë parasysh provigjone për rënie në vlerë, të cilat i referohen kategorisë së aparateve celulare dhe aksesorëve. Një analizë e provigjonit është dhënë si më poshtë:

	2013	2012
Gjendja në fillim të vitit më 1 janar	86,908,353	91,683,173
Rimarrje provigjoni për vitin	(7,514,533)	(4,774,820)
Gjendja në fund të vitit më 31 dhjetor	79,393,820	86,908,353

10. LLOGARI TË ARKËTUESHME, NETO

Llogari të arkëtueshme, neto më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë detajuar si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Pajtimtarë me kontratë	2,433,992,138	2,459,802,411
Shërbime interkoneksioni	626,697,056	926,095,436
Shërbime Roaming	34,475,474	11,613,936
Shërbime interkoneksioni – SMS	29,516,689	29,747,782
Klientë për linja me qira	23,290,475	21,795,319
Shërbime PPRTU	-	296,848
Totali i llogarive të arkëtueshme, bruto	3,147,971,832	3,449,351,732
Zbritje për rënie në vlerë	(2,149,108,849)	(1,997,935,696)
Totali	998,862,983	1,451,416,036

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***10. LLOGARI TË ARKËTUESHME, NETO (VAZHËDIM)**

Llogaritë e arkëtueshme janë raportuar pas zbritjes së rënies në vlerë. Lëvizjet për zbritjen e rënies në vlerë është si më poshtë:

	2013	2012
Gjendja në fillim të vitit më 1 janar	1,997,935,696	1,700,870,581
Zhvlerësimi i vitit	153,521,550	297,065,115
Llogari të arkëtueshme të fshira	(2,348,397)	-
Gjendja në fund të vitit më 31 dhjetor	2,149,108,849	1,997,935,696

11. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME, NETO

Llogari të tjera të arkëtueshme, neto më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Të ardhura të përllogaritura	730,968,847	1,105,522,134
Debitorë të tjerë	700,687,103	329,139,605
Parapagime tatim fitimi (Shënimi 26)	466,122,892	232,964,993
TVSH e arkëtueshme	-	8,575,212
Të arkëtueshme nga agjentët	14,769,719	7,692,159
Paradhënie dhe kredi për punonjësit	966,119	4,193,403
Totali	1,913,514,680	1,688,087,506

Të ardhurat e përllogaritura përfshijnë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Shërbime interkoneksioni	509,685,373	838,608,627
Pajtimtarë me kontratë	190,866,675	234,843,174
Shërbime interkoneksioni SMS	11,556,381	8,306,000
Shërbime roaming	9,641,665	17,282,325
Të tjera	9,218,753	6,482,008
Totali	730,968,847	1,105,522,134

Shtesa të debitorëve të tjerë përfshijnë shumat e paguara për autoritetet tatimore, të paguara në përputhje me gjetjet e organeve tatimore në lidhje me TVSH, tatimin mbi të ardhurat e korporatave dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën deri më 31 tetor 2012. Shoqëria po mban këto balanca si parapagimet, derisa të merret vendimi përfundimtar nga organet tatimore. Debitorë të tjerë përfshijnë llogari të arkëtueshme nga Autoritetet Tatimore në lidhje me tatimin në burim të paguar, por që përjashtohen për shkak të marrëveshjes së tatimit të dyfishtë me Greqinë. Shoqëria ka bërë kërkesë në lidhje me këto tatime për t'u rimbursuar.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***12. MJETE MONETARE NË ARKË DHE BANKË**

Mjete monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Para në dorë	2,126,462	4,662,664
<i>Në Lek</i>	<i>1,986,070</i>	<i>3,717,796</i>
<i>Në monedhë të huaj</i>	<i>140,392</i>	<i>944,868</i>
Llogari rrjedhëse	1,514,903,267	2,054,683,146
<i>Në Lek</i>	<i>1,442,881,382</i>	<i>1,650,484,951</i>
<i>Në monedhë të huaj</i>	<i>72,021,885</i>	<i>404,198,195</i>
Depozita me afat	3,230,000,000	3,406,720,000
<i>Në Lek</i>	<i>3,230,000,000</i>	<i>2,290,000,000</i>
<i>Në monedhë të huaj</i>	<i>-</i>	<i>1,116,720,000</i>
Totali	4,747,029,729	5,466,065,810

Depozita me afat përbëhet nga depozita afatshkurtra në bankat vendase me maturim deri në 2 javë. Këto depozita përfitojnë interesa vjetore nga 2.5% deri në 3.5% për depozitat në Lek (2012: 5.2% to 5.6%).

13. KAPITALI AKSIONAR

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
<i>Kapitali i nënshkruar</i>		
437,400 aksione të zakonshme me vlerë 100 Euro secili	5,689,874,341	5,689,874,341
Totali	5,689,874,341	5,689,874,341

14. REZERVA LIGJORE

Rezerva ligjore është krijuar në zbatim të Nenit 213 të Ligjit No. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", tashmë zëvendësuar me Ligjin Nr. 9901 dated 14.04.2008 "Për Shoqëritë tregtare" (neni 127). Bazuar në këtë ligj, rezerva ligjore duhet të krijohet deri në masën 1/10 të kapitalit të nënshkruar. Të gjitha rezervat mbi këtë shumë nuk janë të detyrueshme dhe duhet të konsiderohen si rezerva statutore.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek. përveç kur shprehet ndryshe)***15. LLOGARI TË PAGUESHME**

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë.

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Detyrime ndaj furnitorëve për aktive afatgjata materiale	831,597,432	922,348,326
Detyrime ndaj furnitorëve për shërbime - VF Group	677,199,559	3,388,116,456
Detyrime ndaj furnitorëve për shërbime	470,675,346	497,599,407
Llogari të tjera të pagueshme	10,814,912	10,553,597
Totali	1,990,287,249	4,818,617,786

16. LLOGARI TË TJERA TË PAGUESHME

Llogaritë e tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë.

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Depozita garanci	326,834,854	432,364,441
Shpenzime të përlogaritura	136,426,491	114,334,443
Detyrime të tjera	26,294,634	31,555,079
Totali	489,555,979	578,253,963

17. DETYRIME NDAJ AKSIONARËVE

Shuma e dividendëve të deklaruar dhe paguar gjatë vitit 2013 dhe 2012 është si më poshtë:

	Dividend
Gjendja më 1 janar 2012	-
Dividendë të deklaruar gjatë vitit 2012	3,381,741,734
Dividendë të paguar gjatë vitit 2012	(3,381,741,734)
Gjendja më 31 dhjetor 2012	-
Dividendë të deklaruar gjatë vitit 2013	1,469,323,754
Dividendë të paguar gjatë vitit 2013	(1,469,323,754)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	-

Dividendët e deklaruar janë shpërndarë tek aksionarët e Shoqërisë si më poshtë:

	2013	2012
Vodafone Europe BV	734,661,877	1,690,870,867
Vodafone Panafon International Holdings BV	734,661,877	1,690,870,867
Totali	1,469,323,754	3,381,741,734

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***18. DETYRIME TATIMORE NDAJ SHTETIT**

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
TVSH për t'u paguar	39,350,191	52,106,727
Tatim në burim	566,634	1,118,993
Totali	39,916,825	53,225,720

19. PROVIGJONE PËR TAKSA DHE ÇËSHTJE GJYQËSORE

		Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Provigjone për penalitete për TVSH dhe tatimin në burim	19.1	152,141,682	152,140,880
Provigjone për interesa për pagesa të vonuara		98,500,588	74,500,588
Provigjone për tatimin mbi fitimin	19.2	317,106,009	253,641,469
Provigjone për çështje ligjore të tjera	19.3	35,476,228	27,000,000
Totali		603,224,507	507,282,937

19.1 Detyrimet dhe penalitetet nga kontrollet e krvera nga Autoritet Tatimore

Autoritetet Tatimore audituan Vodafone Albania për vitet nga 2007 deri në maj 2010 dhe lëshuan një raport përfundimtar lidhur me tatimin mbi fitimin, TVSH dhe taksat e sigurimeve shoqërore, për të cilën Vodafone Albania sh.a. apeloj më 20 maj 2011 pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor. Apeli Tatimor vendosi të pranojnë pjesërisht ankesën e VFAL në lidhje me tatimin mbi fitimin për shërbimet e marra nga kompanitë e huaja. VFAL nisi një padi në Gjykatën e Shkallës së parë kundër vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor në lidhje me detyrimet tatimore. Përsa i përket kontrollit tatimor të përmendur më sipër, Zyra e Taksave nisi një padi kundër Drejtorisë së Apelimit Tatimor, ku VFAL është quajtur si palë e tretë. Zyra e Taksave kundërshtoi vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor lidhur me pretendimet e VFAL të cilat u aprovuan nga Drejtoria e Apelimit Tatimor. Në vendimin e datës 26 mars 2012, Gjykata e Tiranës refuzoi padinë e Zyrës së Taksave. Në 12 maj 2014, Gjykata Administrative e Tiranës hodhi poshtë çështjen. Vodafone Albania do të apelojë vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

19.2 Provigjone për detyrimet tatimore mbi të ardhurat e korporatave

Provigjonet për tatimin mbi të ardhurat e korporatave janë krijuar nga Drejtimi bazuar në vlerësimet më të mira të tyre dhe përvojën e viteve paraardhëse me kontrollet tatimore. Provigjone të tilla krijohen për të mbuluar humbje të mundshme që mund të lindin nga kontrolle të ardhshme tatimore.

19.3 Detyrime për çështje të tjera ligjore

Provigjone për çështje ligjore të tjera përfaqëson gjoba dhe penalitete të lidhura me: a) pretendime të autoriteteve vendore për pagesë të taksave lokale, si dhe b) pretendime të individëve dhe institucioneve lokale për pagesa të qirave.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***20. TË ARDHURA TË SHTYRA**

Të ardhura të shtyra kanë të bëjnë me kohën bisedore të përdorur nga shitja e produkteve me parapagesë gjatë vitit 2013, por e përdorur totalisht deri më 31 dhjetor 2013.

Të ardhurat e shtyra dhe të llogaritura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraqiten si më poshtë.

	2013	2012
Gjendja në fillim të vitit	581,994,981	697,678,418
Kohë bisede shitur gjatë vitit	8,638,366,768	8,728,267,439
Kohë bisede përdorur gjatë vitit	(8,591,575,366)	(8,843,950,876)
Totali	628,786,383	581,994,981

21. TË ARDHURA

Në të dy vitet ushtrimore të mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012, të ardhurat janë realizuar nga shërbimet e telefonisë celulare në Shqipëri. Të ardhurat për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura nga pajtimtarët me parapagesë	8,449,289,987	8,592,387,658
Të ardhura nga interkoneksioni	6,707,590,735	10,775,926,798
Të ardhura nga pajtimtarët me kontratë	2,448,293,489	3,032,171,768
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	394,721,276	319,137,664
Të ardhura nga interkoneksioni - SMS	135,151,616	158,854,386
Të ardhura nga shërbimi roaming	107,434,583	198,730,661
Të ardhura nga ndërlidhja e shoqërive	58,368,506	-
GPRS trafik	39,824,871	88,441,513
MMS trafik	2,166,312	1,558,339
Të ardhura të tjera	5,708,786	1,296,781
PPRTU trafik	-	561,047
Totali	18,348,550,161	23,169,066,615

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***22. KOSTO E SHITJES**

Kosto e kohës së bisedës dhe e interkoneksionit për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 është e detajuar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Shpenzime ndërmjet kompanive	3,384,380,341	6,128,393,872
Amortizim rrjeti	3,048,606,223	2,859,355,984
Kosto interkoneksioni	1,200,912,885	1,522,641,189
Shpenzime për mirëmbajtjen e rrjetit	972,334,421	943,949,205
Komision i distributorëve për shitje top-up	699,844,204	738,006,922
Amortizimi i liçensës	661,167,000	662,978,414
Kosto të pajisjeve	542,368,128	610,330,200
Shpenzime për energji elektrike dhe të tjera	221,046,081	351,784,806
Shpenzime për pagat	347,782,139	332,371,364
Shpenzime qiraje	256,870,156	265,995,337
Komisione të tjera për shitjen	314,242,579	211,433,910
Shërbime të tjera	149,343,056	161,244,211
Tarifë për Entin Rregullator	153,934,436	140,651,275
Shpenzime mirëmbajtje për zyrat	98,591,694	11,020,026
Komisione për mbledhjen e arkëtimeve	47,392,275	51,252,644
Shërbime nga të tretë jashtë Shoqërisë	27,038,535	26,934,749
Shpenzime për kontraktorët	18,458,453	235,375
Shpenzime udhëtime dhe akomodime	11,846,434	18,479,931
Kosto e linjave me qira	4,050,225	12,973,551
Mirëmbajtje e rrjetit informatik	1,353,974	15,427,870
Kosto të tjera	-	6,729,948
Reklama dhe publicitet	-	13,201
Shërbime këshillimi	18,267	-
Shpenzime të kapitalizuara	(18,705,396)	(14,283,489)
Totali	12,142,876,110	15,057,920,495

23. SHPENZIME SHITJE DHE SHPËRNDARJE

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Reklama dhe publicitet	779,179,397	916,151,596
Shpenzime për paga	277,519,754	248,099,475
Të tjera	88,205,955	119,556,994
Shpenzime për mirëmbajtje zyre	49,054,652	59,120,487
Shpenzime udhëtime dhe akomodime	42,733,959	58,570,437
Shpenzime për kontraktorë	14,204,249	6,381,405
Kosto e linjave me qira	9,313,963	6,851,471
Shërbime nga të tretë jashtë Shoqërisë	2,406,263	2,738,146
Mirëmbajtje rrjeti	52,501	-
Mirëmbajtje e rrjetit informatik	27,584	593,421
Tarifa këshillimi	11,000	-
Totali	1,262,709,277	1,418,063,432

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***24. SHPENZIME ADMINISTRATIVE**

Shpenzimet administrative janë detajuar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Shpenzime për paga	443,945,289	351,056,518
Mirëmbajtje e rrjetit informatik	155,220,491	124,628,356
Zhvlerësime të tjera	149,873,393	123,520,079
Shërbime të tjera	95,822,767	132,228,336
Shpenzime për udhëtime dhe akomodime	62,803,915	51,352,096
Shpenzime për mirëmbajtje zyre	61,738,854	43,843,617
Tarifa këshillimi	41,944,575	3,037,097
Shërbime nga të tretë jashtë Shoqërisë	34,147,883	55,875,245
Reklama dhe publicitet	25,725,282	2,525,393
Amortizime të tjera	24,210,677	25,155,810
Shpërblime mbi bazë aksioni	17,253,244	23,550,839
Shpenzime të tjera rrjeti për administratën	13,935,543	-
Komisione bankare	8,831,615	10,009,463
Shpenzime për kontraktorë	6,730,630	50,215,930
Shpenzime qiraje të linjave për administratën	1,294,945	4,521,398
Shpenzime mirëmbajtje rrjeti	197,720	6,790,182
Kosto e linjave me qira	22,874	-
Shpenzime të kapitalizuara	(2,945,286)	(4,279,195)
Totali	1,140,754,411	1,004,031,164

25. (SHPENZIME) / TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE

(Shpenzime) / të ardhura të tjera operative përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Zhvlerësimi për llogari të dyshimta	(153,521,550)	(297,065,115)
Gjoha dhe penalitete	-	(248,435,660)
Shpenzime të tjera	(114,697,368)	(77,247,335)
Provizione për rënien në vlerë dhe nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve	(59,770,181)	(27,547,955)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve	(25,814,671)	(481,727)
Rimarrje për gjoha dhe penalitete	-	303,705,288
Të ardhura të tjera	4,420,055	270,086,839
Linjat me qira	60,639,595	76,928,107
Provizione për zhvlerësimin e mallrave	7,514,531	4,774,820
Tarifa të anulimit të lidhjeve	-	3,712,633
Totali neto (shpenzime)/ të ardhura	(281,229,589)	8,429,895

Shoqëria i paraqet shpenzimet dhe të ardhurat nga veprimtaritë operative në baza neto.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe).***26. TATIMI MBI FITIMIN**

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Tatimet aktuale në masën 10% (2012:10%)	517,309,438	741,640,952
Tatim fitimi i shtyrë	(246,067,010)	-
Totali	271,242,428	752,516,286

Norma standarde e tatim fitimit për vitin, bazuar në normën standarde të tatim fitimit sipas legjislacionit shqiptar, është 10% (2012:10%). Shpenzimi për vitin mund të rakordohet me fitimin kontabël si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Norma efektive e tatimit	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	Norma efektive e tatimit
Fitimi para tatimit	3,564,107,893		5,771,663,589	
Tatimi mbi fitimin mbi aktivitetin normal në normën 10% (2012:10%)	356,410,789	10%	577,166,359	10%
<i>Efekti në tatim mbi fitimin i shpenzimeve të panjohura për qëllime fiskale:</i>				
Pritje dhe dhurata	53,050,468	1.5%	33,608,995	0.58%
Gjoha dhe penalitete	27,972	0.001%	25,800,031	0.45%
Zhvlerësim për aktivet afatgjata	27,027,967	0.76%	77,313,423	1.34%
Zhvlerësim për aktive afatshkurtra	15,352,155	0.43%	29,706,512	0.51%
Provizione për penalitete	3,247,623	0.09%	(27,457,053)	(0.48%)
Qira e paguar për punonjësit e huaj	1,346,669	0.04%	1,857,565	0.03%
Kostot për Fondacionin Vodafone	2,786,899	0.08%	5,095,032	0.09%
Të tjera	9,418,254	2.64%	8,322,591	0.14%
Provizione për penalitete të mundshme për tatim fitimin	63,464,542	1.78%	45,664,821	0.79%
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin i njohur për vitin	532,133,338	14.78%	777,078,276	13.46%

Rakordim me shpenzime për tatimin mbi fitimin:

Efekti në tatim fitim si rezultat i ndryshimeve të përkohshme

Rregullimi i zhvlerësimit	(57,157,345)	(1.60%)	(60,400,498)	(1.05%)
Rregullimi i amortizimit	37,654,306	1.06%	36,531,518	0.63%
Të ardhura nga pajtimtarët me parapagesë	4,679,139	0.13%	(11,568,344)	(0.20%)

Detyrimi afatshkurtër për tatimin mbi fitimin

	517,309,438	14.51%	741,640,952	12.85%
--	--------------------	---------------	--------------------	---------------

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***26. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Tatimi mbi fitimin për t'u paguar / (për t'u arkëtuar) dhe provigjonet e bëra nga Shoqëria për gjobat tatimore të mundshme, bazuar në eksperiencat e mëparshme, janë përmbledhur si më poshtë. Tatimi mbi fitimin afatshkurtër (parapagimet) dhe provigjonet për detyrime të mundshme për tatimet më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraqiten bruto në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Tatimi aktual për t'u paguar / (arkëtuar)	Provigjon për detyrimin aktual tatimor	Totali
(Aktiv) / detyrim tatimor afatshkurtër më 1 janar 2012	(277,891,322)	207,976,648	(69,914,674)
Shpenzimi i vitit	695,976,132	45,664,821	741,640,953
Tatim fitimi i paguar	(651,049,803)	-	(651,049,803)
(Aktiv) / detyrim tatimor afatshkurtër më 31 dhjetor 2012	(232,964,993)	253,641,469	20,676,476
Shpenzimi i vitit	453,844,897	63,464,541	517,309,438
Tatim fitimi i përdorur për kompensimin e gjobave	279,723	-	279,723
Tatim fitimi i paguar	(687,282,519)	-	(687,282,519)
(Aktiv) / detyrim afatshkurtër tatimor më 31 dhjetor 2013	(466,122,892)	317,106,010	(149,016,882)

27. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe Drejtuesit e Shoqërisë, së bashku me entitetet, të cilët kontrollojnë ose ushtrojnë influencë domethënëse. Lista e palëve të lidhura dhe marrëdhënia e tyre më 31 dhjetor 2013 është si më poshtë:

Palët

Vodafone Network PTY Limited
Vodafone D2 GMBH
Vodafone Espana S.A.U
Vodafone Czech Republic A.S
Vodafone Omnitel N.V
Vodafone Portugal
Vodafone Limited
Vodafone Panafone Hellenic
Vodafone Hungary Mobile Ltd
Vodafone Libertel B.V
Vodafone Romania S.A
Vodafone Ireland Ltd
Vodafone Egypt Telecommunications
Vodafone New Zeland Limited
Vodafone Malta Limited
Vodafone Telekommunikasyon A.S
Vodafone Essar Mobile Services Limited
Vodafone Global Products & Services
Vodafone Procurement Company
Vodacom Group Ltd
Cable and Éireless
Vodafone Group Service Ltd
Vodafone Sales and Services
Vodafone Roaming Services
Vodafone Europe B.V
Vodafone Panafon International Holdings B.V

Marrëdhënia

Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Palë e lidhur
Aksionar
Aksionar

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***27. TRANSAKSIONE ME PALËT TË LIDHURA (VAZHDIM)****Transaksione tregtare:**

Gjatë vitit Shoqëria ka kryer transaksione tregtare me palët e lidhura që janë anëtarë të Vodafone Group Plc si më poshtë:

	Shitje e produkteve dhe shërbimeve (000' Lek)		Blerje e produkteve dhe shërbimeve (000' Lek)	
	2013	2012	2013	2012
Shoqëritë pjesëmarrëse	3,765,532	2,775,003	3,784,641	6,507,497

Balancat e papaguara me palët e lidhura, paraqiten si më poshtë:

	Vlera të papaguara nga palët e lidhura (000' Lek)		Vlera të papaguara për palët e lidhura (000' Lek)	
	2013	2012	2013	2012
Shoqëritë pjesëmarrëse	317,336	11,838	677,199	3,516,401

Shpërblimi i Drejtorëve, interesa dhe transaksione

Bordi i Drejtuesve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013 përbëhet nga:

Marios Ioannis Giatzidis	Kryetar dhe Anëtar
Dietlof Ziegfried Mare	Anëtar
Alma Varfi	Anëtar

Kontributi i Drejtuesve është paguar nga entitet e tjera të Vodafone Group për vitin ushtrimor aktual dhe paraardhës. Asnjë nga shpërblimet e tyre nuk është specifikisht i lidhur me shërbimet e tyre për Shoqërinë.

28. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Menjëherë pas kontrollit tatimor të Vodafone Albania për të vitet Janar 2010 deri në tetor 2012, detyrimet nga kontrolli (duke përjashtuar gjobat), u paguan në zyrën tatimore, në mënyrë që të vazhdohet më tej me procedurat e apelimit. Në datën e përcaktuar për plotësimin e dokumentave për apelim, autoritetet tatimore lëshuan një njoftim për një rikontroll tatimor për Vodafone Albania për të njëjtin objekt dhe të njëjtën periudhë. Vodafone Albania ka apeluar detyrimet dhe gjobat ne Drejtorinë Tatimore të Apelit dhe do ti drejtohet Autoriteteve Tatimore për rimbursim të vlerës së parapaguar.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që do kishin nevojë për rregullime ose shënime shpjeguese në pasqyrat financiare të veçanta.

Vodafone Albania sh.a.

Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

29. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

Angazhime për qira operative

Angazhimet vjetore për qira operative jo të anulueshme janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2013 (000's LEK)	31 dhjetor 2012 (000's LEK)
Data e mbarimit të afatit:		
- brenda 1 viti	33,599	108,690
- 1 deri në 5 vjet	197,666	123,656
- pas 5 vitesh	83,145	114,304
Totali	314,410	346,651

Qiratë operative lidhen me kontratat e qirave për antenat, apartamentet, zyrat dhe dyqanet Vodafone, datat e mbarimit të afatit të cilave variojnë nga një deri në tridhjetë vjet.

Çështje gjyqësore

Përveç sa është përmendur në Shënimin 19, Shoqëria është subjekt i çështjeve të tjera ligjore, pretendimeve dhe çështjeve gjyqësore që kanë lindur gjatë veprimtarisë normale së biznesit. Drejtimi beson se ndonjë zhvillim i mundshëm nuk do të ketë ndikim material jo të favorshëm në pozicionin financiar të Vodafone Albania, rezultatet operative apo rrjedhëm e parasë.

30. SHOQËRIA KONTROLLUESE DHE SHOQËRIA E FUNDIT KONTROLLUESE

Siç përmendet në Shënimin 1, më 31 dhjetor 2013, aksionarët e Vodafone Albania sh.a. ishin Vodafone Europe B.V. dhe Vodafone Panafon International Holdings B.V. (një shoqëri e vendosur në Hollandë), të cilat zotëronin secila 50% të kapitalit të nënshkruar. Përderisa Vodafone Group Plc (një kompani e vendosur në Angli) zotëron 100% të Vodafone Europe B.V. dhe 99.8% të Vodafone Panafon International Holdings B.V., mund të konsiderohet si aksionari indirekt për Vodafone Albania sh.a. për 99.9% të kapitalit të nënshkruar dhe si rrjedhojë shoqëria e fundit kontrolluese për Shoqërinë.

Vodafone Group Plc është shoqëria e fundit kontrolluese. Pasqyrat financiare të konsoliduara të Vodafone Group Plc mund të sigurohen nga Sekretaria e Shoqërisë, Vodafone Group Plc, Vodafone House, The Connection, Newbury, Berkshire, RG14 2FN, Angli ose nga adresa elektronike e Shoqërisë.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***31. MANAXHIMI I RREZIKUR FINANCIAR****a. Rreziku i kreditimit**

Shoqëria konsideron se ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kreditimit më 31 dhjetor 2013 vjen nga vlera kontabël e aktiveve financiare, si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Para në bankë	4,744,903,267	5,461,403,146
Llogari të tjera të arkëtueshme	1,913,514,680	1,688,087,506
Llogari të arkëtueshme	998,862,983	1,451,416,036
Totali	7,657,280,930	8,600,906,688

Në përcaktimin e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme, Shoqëria konsideron çdo ndryshim në cilësinë kredituese të klientëve nga data e kreditimit deri në fundin e periudhës së raportimit. Përqendrimi i rrezikut të kreditimit është i kufizuar pasi klientët janë të një game të gjerë dhe jo të lidhur me njëri tjetrin.

Llogaritë e arkëtueshme kryesisht përfshijnë klientët me kontratë, individë apo subjekte (29%) dhe klientë për interkoneksionin (31%). Totali i klientëve është detajuar sipas klientit në Shënimin 10. Llogaritë monitorohen nga Drejtimi dhe krijohen zhvlerësime për borxhin e keq dhe të dyshimtë aty ku shihet e arsyeshme.

Një analizë e rrezikut të kreditimit është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2013		31 dhjetor 2012	
	Bruto	Rënia në vlerë	Bruto	Rënia në vlerë
Klientë me kontratë (Vendas)	2,433,992,138	2,149,108,849	2,459,802,411	1,997,935,696
Partnerë Interkoneksioni				
Vendas	53,428,958	-	80,142,705	-
Europë	255,931,951	-	845,952,731	-
Klientë Roaming (Ndërkombëtare)	34,475,474	-	11,613,936	-
SMS (Ndërkombëtare)	29,516,689	-	29,747,782	-
Linja me qira (Vendas)	23,290,475	-	21,795,319	-
Të arkëtueshme PPRTU				
Të arkëtueshme nga palët e lidhura (Ndërkombëtare)	317,336,147	-	296,848	-
Totali	3,147,971,832	2,149,108,849	3,449,351,732	1,997,935,696

Në lidhje me të drejtat nga klientët me kontratë, Shoqëria ka njohur një vlerë prej 100% për borxhin e dyshimtë kundrejt të gjitha llogarive të arkëtueshme mbi 180 ditë sepse eksperiencia ka treguar që llogaritë e arkëtueshme mbi 180 ditë nuk janë arkëtuar.

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***31. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****a. Rreziku i kreditimit (vazhdim)**

Tabela më poshtë përfaqëson maturimin nga klientët me kontratë që i ka kaluar afati por që s'janë zhvlerësuar.

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
0 - 30 ditë	103,513,128	155,942,672
30 - 60 ditë	70,801,805	122,181,881
60 - 90 ditë	45,813,338	83,754,838
90 - 120 ditë	33,881,477	59,742,166
120 - 150 ditë	29,930,297	44,664,040
150 - 180 ditë	23,287,208	33,057,334
Balanca debitore	(22,343,964)	(34,476,213)
Totali	284,883,289	461,866,718

Shoqëria mban si kolateral "depozita garanci" mbi këto balanca sikurse pasqyrohet në Shënimin 16.

Përqendrimi i rrezikut të kreditimit në lidhje me llogaritë e arkëtueshme është i kufizuar pasi klientët e Shoqërisë janë të një game të gjerë dhe jo të lidhur me njëri tjetrin. Si rrjedhim i kësaj, Drejtimi beson që nuk ka provigjon shtesë mbi zhvlerësimin normal për borxhin e dyshimtë dhe atë të keq.

b. Rreziku i likuiditetit dhe interesit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të ndeshë vështirësi në krijimin e fondeve për të plotësuar angazhimet e lidhura me instrumentat financiare. Shoqëria monitoron likuiditetet e saj në baza periodike që të manaxhojë detyrimet e saj në momentin që duhen shlyer.

Aktivitet financiar që mbartin interes përbëhen nga llogari rrjedhëse bankare dhe depozita afatshkurtra me bankat.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë ndërtuar bazuar në maturitetet kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare.

	31 dhjetor 2013				
	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 - 5 vjet	Totali
Aktive financiare					
Pa interes	1,531,799,448	2,365,925,290	558,982,991	2,127,284,691	6,583,992,421
Norma fikse	3,230,000,000	-	-	-	3,230,000,000
	4,761,799,448	2,365,925,290	558,982,991	2,127,284,691	9,813,992,421
Detyrime financiare					
Pa interes	83,733,109	1,101,317,711	1,342,502,039	326,834,854	2,854,387,713
Norma luhatëse	-	-	-	-	-
	83,733,109	1,101,317,711	1,342,502,039	326,834,854	2,854,387,713

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***31. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****b. Rreziku i likuiditetit dhe interesit (vazhdim)**

	31 dhjetor 2012			
	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 - 5 vjet
<u>Aktivët financiarë</u>				Totali
Pa interes	3,238,553,273	2,159,035,515	1,079,517,758	719,678,505
Norma fikse	3,406,720,000	-	-	-
	6,645,273,273	2,159,035,515	1,079,517,758	719,678,505
				10,603,505,051

Detyrimet financiare

Pa interes	-	1,005,640,553	3,417,245,479	1,044,356,105	5,467,242,137
Norma luhatëse	-	-	-	-	-
	-	1,005,640,553	3,417,245,479	1,044,356,105	5,467,242,137

c. Rreziku i monedhës së huaj

Rreziku i valutës është rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet nga ndryshimi i kursit të valutës. Shoqëria nuk është dukshëm e ekspozuar ndaj rrezikut të valutës sepse të ardhurat pranojnë në monedhën raportuese.

	Më 31 dhjetor 2013			
	EURO	USD	GBP	LEK
Aktive financiare	848,408,999	1,685,787	1,545,175	8,962,352,460
Detyrime financiare	1,540,217,744	34,306,654	1,074,527	1,278,788,788
Totali	(691,808,745)	(32,620,867)	470,648	7,683,563,672
				6,959,604,708

	Më 31 dhjetor 2012			
	EURO	USD	GBP	LEK
Aktive financiare	2,457,326,852	11,928,558	654,461	8,133,595,180
Detyrime financiare	4,647,155,816	2,733,621	5,467,241	811,885,458
Totali	(2,189,828,964)	9,194,937	(4,812,780)	7,321,709,722
				5,136,262,915

Vodafone Albania sh.a.**Shënime mbi pasqyrat e veçanta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

31. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**c. Rreziku i monedhës së huaj (vazhdim)**

Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhave të huaja

Analiza e ndjeshmërisë ndaj valutave është ndërtuar duke u bazuar në ekspozimin në valuta në datën e raportimit dhe ndryshimet e bëra në fillim të vitit financiar dhe të mbajtura konstante gjatë periudhës së raportimit. Më poshtë është sistemimi i efekteve të ndryshimit të kurseve të këmbimit në fitimin neto, duke supozuar që të gjitha variablat e tjera janë mbajtur konstante:

	31 dhjetor 2013		31 dhjetor 2012	
	Monedha e huaj vlerësohet me 10% kundrejt Lek-ut	Monedha e huaj zhvlerësohet me 10% kundrejt Lek-ut	Monedha e huaj vlerësohet me 10% kundrejt Lek-ut	Monedha e huaj zhvlerësohet me 10% kundrejt Lek-ut
EURO	(69,180,875)	69,180,875	(218,982,896)	218,982,896
USD	(3,262,087)	3,262,087	919,494	(919,494)
GBP	47,065	(47,065)	(481,278)	481,278
	(72,395,896)	72,395,896	(218,544,680)	218,544,680


Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and high-quality service to clients, delivering the insights they need to address their most complex business challenges. Deloitte's approximately 200,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.

###

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani private e limituar nga garancitë, secila prej tyre është entitet ligjor i ndarë dhe i pavarur. Ju lutem shikoni www.deloitte.al/about për një përshkrim më të detajuar të strukturës ligjore të Deloitte Touche Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare.

Deloitte ofron shërbime në auditim, takse, konsulencë dhe shërbime të konsulencës financiare klientëve private dhe publikë në të gjitha industritë që ata operojnë. Me një rrjet global firmash anëtare, në më shumë se 150 shtete, Deloitte sjell ekspertizë me nivel ndërkombëtar dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e saj, duke i dhënë bizneseve njohuritë që i nevojiten për të adresuar sfidat më komplekse që ato hasin. Pothuajse 200,000 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etalon i përsosmërisë.



Str. "Elbasani"
Pallati poshtë Fakultetit
Gjeologji - Miniera
Tirana, Albania

www.deloitte.al

© 2014 Deloitte Albania